ZGJEDHJET E 11 MAJIT

OV TË NUMËRUARA 5215/5225 — SHQIPËRIA 1/2 — AZHORNIMI I FUNDIT 20:50

Partia	%	Mandate
Partia Socialiste e Shqipërisë	52.3 %	83
Partia Demokratike	33.8 %	50
Shqiptarja.com	3.9 %	1
Partia Mundësia	3.1 %	2
	48.7 % ▲	
	46.7 % ▼	
	0.9 %	
	0.0 —	

Kliko këtu për të gjitha rezultatet →

POP 5 — Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1. Numërohen votat e kandidatëve/ PS merr 37 deputetë nga lista e hapur, PD vetëm 7! Gonxheja krysen në Tiranë, Gjikuriut në Vlorë! Tabaku e para nga PD, Meta s'futet në Kuvend
2. Më 15 dhe 16 maj Samiti i Komunitetit Politik Europian, 'paralizohet' kryeqytetit! Bllokohet edhe Rinas-Tiranë, ja akset alternative! Plani i plotë i masave dhe hartat
3. Yll Peta: Nga Asocacioni i 'Vorio Epirit', të 'Republika e Veriut', pse 'Veriu blu' është i pasaktë?
4. Evi Kokalari thirrje demokratëve: Të premtien shkuri dhe protestoni para selisë së PD-së, ndryshe nuk do kemi më parti
5. Rama: Fitore me notën 10! Shqiptarët i kthyen zgjedhjet në referendum për bashkimin me BE! Populli s'e ndërron qeverinë pa ndryshuar më parë opozitën

Kronikë

Lushnjë/ Deklaroi në spital se ishte dëmtuar me mjet prerës, ndërkohë që ishte vetëplagosur me armë, arrestohet 37-vjeçari! Në pranga i vëllai dhe shoku

Një 37 vjeçar i cili shkoi në spitalin e Lushnjës me pretendimin se ishte dëmtuar me mjet prerës ndërkohë që ishte vetëplagosur në makinë me armë zjarri është arrestuar.

Foto Ilustruese

Redaksia
13 Maj, 10:16 | **Përditesimi: 13 Maj, 10:22**

Share

Lushnjë- Një 37 vjeçar i cili shkoi në spitalin e Lushnjës me pretendimin se ishte dëmtuar me mjet prerës ndërkohë që ishte vetëplagosur në makinë me armë zjarri është arrestuar.

Ndërkohë në pranga kanë rënë edhe vëllai dhe shoku i Arens Monkës.

Igli Monka dhe Florjon Veliu fshehën automjetin ku dyshohet se u vetëplagos aksidentalisht 37-vjeçari ndërsa mbështetën edhe deklartën e rreme të tij, tha policia.

LEXO EDHE:
U ndalua për shit-blerje vote në Fier/ GJKKO caktoi masën 'arrest në shtëpi' për babain e kandidates së PSD në Fier

Gjatë kontrollit të kryer blutë gjetën dhe sekuestruan 2 fishekë dhe 1 predhë armësh zjarri.

Njoftimi i policisë:

Pas njoftimit të spitalit të Lushnjës, se një shtetas i dëmtuar në këmbë, kishte shkuar për të marrë mjekim, shërbimet e Komisariatit të Policisë Lushnjë nisën hetimet dhe si rezultat i tyre, zbardhën rrethanat e rastit. Në përfundim të veprimeve hetimore u vunë në pranga, shtetasi i dëmtuar, A. M., 37 vjeç, si dhe vëllai i tij, shtetasi I. M., 33 vjeç, dhe shoku i tij, shtetasi F. V., 40 vjeç.

Nga hetimet e deritanishme dyshohet se 37-vjeçari është vetëplagosur aksidentalisht, në automjet, me një armë zjarri, të cilën e posedonte pa leje. Për të penguar zbulimin e së vërtetës, ky shtetas ka deklaruar në spital, se është dëmtuar aksidentalisht me mjet prerës. Aktualisht, ky shtetas është në kujdesin e mjekëve dhe jashtë rrezikut për jetën.

2 shtetasit e tjerë u arrestuan sepse dyshohet se kanë fshehur automjetin ku u vetëplagos shtetasi A. M., si dhe kanë mbështetur deklaratën e rreme të tij.

Gjatë kontrollit në automjetin e gjetur nga Policia, u gjetën dhe sekuestruan 2 fishekë dhe 1 predhë armësh zjarri.

Në drejtimin e Prokurorisë së Fierit, po punohet për të dokumentuar me prova ligjore, të gjitha rrethanat e këtij rasti.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: vetëplagosje | Arens Monka | Florjon Veliu | Igli Monka | Fier | lushnje

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 14 Maj, 12:13
A do ndikojë vota diasporës në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve?

Po | Jo | Jam i/e dyzuar

Lajme të tjera

Prej tre ditësh 'i humbur' pas disfatës së thellë në Fier, Bardhi shfaqet dhe flet me gjuhën e Berishës: Ishim përballë një bande ministrash dhe drejtorësh të korruptuar!
13 Maj, 22:44

VIDEOLAJM/ Nënkryetarja e KZAZ-së në Fier e PD-së, shpërthen në lot pas humbjes dhe në numërimin të kutisë së fundit
13 Maj, 20:44

Lapaj nga Fieri për Report Tv: Jemi shumë pranë mandatit në Fier, ja marrim PS-së! Luftova për bashkimin e partive të reja, kjo na penalizoi
13 Maj, 18:49

Debat për numërimin në një KZAZ në Fier, numëruesit e PD 'bllokojnë' për disa orë procesin: Nuk njohim 7 kutitë e numëruara nga PS e PSD
13 Maj, 13:19

Mbyllet numërimi, PS mban 'fronin' në qarkun e Fierit, i merr tre mandate PD-së! Diferenca rreth 58 mijë vota! pritet vota e diasporës
13 Maj, 08:45

Mbyllja e procesit të numërimit në Mallakastër festohet me fishekzjarre, PS fiton me rreth 7 mijë vota para! (VIDEO)
12 Maj, 23:30



Arrestimi i babait të kandidates së PSD në Fier, SPAK: I dha para një personi dhe një fletë të ngjashme votimi ku shënohej emri i së bijës
12 Maj, 13:40

Fier/ Debate për numërimin në 3 KZAZ, PD ndërpreu punën! PS numëroi 7 kuti e vetme! Numëruesit e demokratëve: Nuk njohim rezultatin
12 Maj, 12:06

Drejtori i spitalit të Lushnjës në SPAK për blerje votash
12 Maj, 11:30

Kërcënim për votën në rrjete sociale, qytetari kallëzon në polici nënkryetarin e një subjekti politik në Lushnjë
12 Maj, 09:27

Fier/ Arrestohet me urdhër të SPAK babai i kandidates së PSD, Limonera Bozha: S'kemi blerë vota! Sjellje tendencioze, më parë jam intimiduar që të tërhiqem nga gara
12 Maj, 08:33

FOTO LAJM: Ervin Salianji mbjell flokët në burg
11 Maj, 14:13

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje